



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 10 Shkurt 2022

Nr: 48

**V E N D I M**

**P Ë R**

**ZBATIMIN E PROJEKTIT PILOT PËR PROCESIN E VOTIMIT DHE NUMËRIMIT  
ELEKTRONIK TË VOTAVE, PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR  
KRYETAR BASHKIE, TË DATËS 6 MARS 2022, NË BASHKINË VORË,  
QARKU TIRANË**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja "n" dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të vendimit nr. 4, datë 13.11.2020, të Komisionit Rregullator, "Për llojin dhe karakteristikat teknike që duhet të plotësojnë sistemet dhe pajisjet e votimit dhe numërimit elektronik që prokurohen dhe përdoren në zgjedhje në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**V E N D O S I:**

1. Zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, në bashkinë Vorë, qarku Tiranë.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 10 Shkurt 2022

Nr. 48

"Për zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022, në bashkinë Vorë, qarku Tiranë"